

VENDIM
Nr. 868, datë 12.12.2007

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT NDËRTIMOR E
URBANISTIK KOMBËTAR

(Ndryshuar me VKM nr. 548, datë 7.7.2010)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” dhe të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar është institucion qendror, buxhetor, person juridik, publik në varësi të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, me seli në Tiranë.

2. *Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Struktura dhe organika e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.*

3. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përkatës.

4. Kryeinspektori organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar dhe përgjigjet para ministrit.

5. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.7.2005 “Për Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

6. Punonjësit e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar duhet të plotësojnë kërkesat, e përgjithshme dhe të veçanta, që përcaktohen nga kryeinspektori, në përputhje me nenin 11 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.

7. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA